



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 16  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 8 maj 2018, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

**Munguan:** Faton Topalli, dhe Time Kadrijaj.

**Të ftuar:** Halil Kurmehaj, Jusuf Fazliu, Jasmin Maksuti, Fatbardha Salihu, përfaqësues nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.4.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare;**
- 4. Takim me përfaqësues nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.4.2018;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.4.2018, u miratua pa vërejtje.

- 3. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare;**

**Besa Baftiu, kryetare e Komisionit**, tha se sot e kemi për shqyrtim raportin e monitorimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare. Grupi i punës e ka përgatitur raportin, të cilin po e shqyrtojmë sot dhe ka bërë një punë shumë të mirë si dhe e ka përfunduar monitorimin sipas planit dinamik. Siç e keni parë, kanë dalë disa rekomandime të cilat pas miratimit të tyre, shpresojmë që të adresohen nga ana e Qeverisë, respektivisht MPMS-ja.

Vlen të theksohet se grupi punues gjatë këtij monitorimi, pati një bashkëpunim shumë të mirë me organizatën UNICEF si dhe Koalicionin e Organizatave për Mbrojtjen Fëmijëve OJQ KOMF.

**Komisioni**, pas diskutimeve, nxori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet Raporti për monitorimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.
2. Raporti procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare.

### **4. Takim me përfaqësues nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve;**

**Besda Baftiu, kryetare**, tha se kemi ftuar përfaqësues nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve, të cilët përmes një shkrese të paraqitur kohë më parë, kanë shprehur shqetësimet e tyre për moszbatimin e legjislacionit sa i përket realizimit të të drejtave të tyre që parashihen me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesit nga Iniciativa e Pavarur e të Verbërve**, theksuan se, si iniciativë ju kanë drejtuar të gjitha institucioneve me shqetësimin tyre për moszbatimin e legjislacionit për persona të verbër. Kemi shprehur pakënaqësinë tonë edhe përmes protestës me moton “Ne duam punë”. Njëherësh kemi kërkuar nga institucionet e Republikës së Kosovës që të bëjnë zbatimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pra kornizës ligjore për aftësinë e kufizuar të ligjit për personat e verbër në veçanti. Dhe në këtë rast edhe para jush paraqesim kërkesat tona si iniciativë. Barazi para ligjit, neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mos diskrimino aftësinë e kufizuar (nen 1 i ligjit për mbrojtjen e diskriminimit).

Duam trajtim të barabartë, asgjë më shumë.

Duam punë (neni 5, i Ligjit për personat e verbër). Qasje në transport (Neni 13 i Ligjit për personat e verbër).

Duam lehtësime në sistemin e drejtësisë (neni 19 i Ligjit për personat e verbër). Kërkojmë shërbime të dinjitetshme shëndetësore (neni 9 i Ligjit për personat e verbër).

Duam edukim dhe arsimim cilësor (Ligji për personat e verbër, Neni 10).

Duam qasje të barabartë në informata (Neni 11 i Ligjit për personat e verbër).

Duam punësim (Ligji për punësim dhe riaftësim, Neni 12).

Duam strehim për personat e verbër dhe me të pamë të dobësuar ( Ligji për personat e verbër, Neni 8).

Duam rehabilitim (Neni 12 i Ligjit për personat e verbër).

Duam lehtësira në shfrytëzimin e energjisë elektrike (Neni 14, Ligji për personat e verbër).

Duam ndërrim të Komisionit mediko-social, sipas ligjit neni 17, i Ligjit për personat e verbër. Këto janë kërkesat tona, u tha, të cilat shpresojmë që t'i adresoni sa më parë.

**Komisioni**, diskutoi pothuajse për të gjitha shqetësimet që u ngritën nga përfaqësuesit e Iniciativës së pavarur të personave të verbër. Anëtarët e komisionit njëzëri shprehen shqetësimin me moszbatimin e legjislacionit në përgjithësi, e në këtë rast legjislacioni për personat me aftësi të kufizuar apo personat e verbër. Të gjithë deputetët e pranishëm shprehen gatishmërinë se kërkesat e Iniciativës së personave të verbër, do të shqyrtohen dhe do të kërkohet edhe nga ministrinë përkatëse që të bëjnë zbatimin e legjislacionit, në këtë rast ofrimin e përkrahjes apo realizimit të drejtave që parashihen me legjislacionin për personat e verbër.

Komisioni, njëherësh vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MPMS-së që të raportojë në lidhje me zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuar, respektivisht personat e verbër.

#### **4. Të ndryshme.**

**Besa Baftiu, kryetare**, tha se kemi pranuar një kërkesë nga Oda e Farmacistëve të Kosovës, të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre pse nuk janë pjesë e Bordit të Fondit për Sigurimet. Në këtë rast, në bazë të Ligjit për sigurimet shëndetësorë, duhet të këtë konsensus ndërmjeti odave që të dërgojnë një përfaqësues në bord. Në këtë rast në Bord është emëruar përfaqësuesi i Odës së Mjekëve të Kosovës. Këtë çështje ne do të diskutojmë me ministrin e MSH-së, edhe pse në këtë rast është dashtë që të kemi një konsensus nga odat e profesionistëve shëndetësorë që të dërgojnë një përfaqësues të tyre në Bord.

Për pikën të ndryshme, kemi shqyrtimin e Projektligjit për gjak dhe përbërësit e gjakut. Komisioni vendosi që për shqyrtimin e Projektligjit për gjak dhe përbërësit e gjakut, grupi punues të organizojë punëtori në Vila Gërmia, me përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë dhe përfaqësuesit nga Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**